

UDHËZIM
Nr. 30, datë 16.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 15.4.2016 “PROCEDURAT E PËRLLOGARITJES SË PËRFITIMEVE NGA LIGJET E MËPARSHME DHE TË PAGESAVE TË DËMSPËRBLIMIT PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 11, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 14.4.2011 “Për miratimin e afateve dhe skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1253, datë 2.7.2008 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të vlerësimit për dëmshpërblimin e përfituar nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5, datë 15.4.2016, “Procedurat e përllogaritjes së përfitimeve nga ligjet e mëparshme dhe të pagesave të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në paragrafin III, “Procedurat dhe përgjegjësitë për shpërndarjen e dëmshpërblimit financiar të ish-të dënuarve politikë të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave”, pikat 2, 3 dhe 4 ndryshojnë me këtë përmbajtje:

“2. Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit të ish-të dënuarve politikë nga regjimi komunist do të ndahet në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit, me kusht që kësti i dëmshpërblimit të mos jetë më i madh se 1 000 000 (një milion) lekë”.

“3. Për të gjitha subjektet përfituese parësore, kur vlera totale e dëmshpërblimit është mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë, do të vijohet me pagesën e kështit pasardhës deri në shpërndarjen e plotë të shumës së miratuar”.

“4. Në rast se vlera totale e miratuar për të gjithë përfituesit është deri në 1 000 000 (një milion) lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit do të kryhet me një kësht të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit. Me kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit, për të gjithë përfituesit, brenda kështit më të ulët, fillon pagesa e kështit pasardhës. Ky mekanizëm do të përsëritet deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit.”.

2. Kudo në përmbajtjen e udhëzimit, emërtimet “Ministria e Financave”, “ministri i Financave”, zëvendësohen përkatësisht me togfjalëshin “ministria përgjegjëse për financat” dhe “ministri përgjegjës për financat”.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj